

ADINGPOKS 1PV

Lyerës paraprak epoksidik me viskozitet të ulët për sipërfaqe të lagështa të betonit

I përgjigjet standardit EN 1504-2, metoda 2.2(C) u 8.2(C); EN 13813 SR-B2.0-IR4

FUSHA E APLIKIMIT

Si lyerës paraprak të gjithë sistemet epoksidike. Për impregnim dhe përmirësim të veçorive fizike dhe mekanike të sipërfaqeve të betonit ose sipërfaqeve nga llaçi i çimentos. Për mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit të ekspozuara nga ndikimet mekanike dhe agresioni kimik. Gjatë përzjerjes së rërës së kuarcit mund të fitohet llaç epoksidik me karakteristika të larta fiziko-mekanike që përdoret për sanacionin (riparimin) e dëmtimeve të konstruktive të betonit. ADINGPOKS 1PV aplikohet si pjesë e sistemit për përpunimin e shtigjeve të këmbësorëve në ura në kombinim me mbështjellës (lyerës) finalë në bazë të rrëshirës metakrilike ADINGMARKER P ose ADINGKOLOR RF. Adingpoks 1PV përdoret edhe si pjesë e sistemit hidroizolues për konstruksione urash në kombinim me rërë kuarci dhe shirita bitumeni. Si shtresë bazë epoksidi te këto sisteme, Adingpoks 1PV u përballon ndryshimeve termike gjatë ngjitjes së shiritave të bitumoni dhe gjatë futjes në asfalt.

Për shkak të viskozitetit të ulët të produktit, Adingpox 1PV përdoret për mbushjen dhe injektimin e çarjeve me gjerësi më të madhe se 0,1 mm. Kjo bën të mundur krijimin e një lidhjeje konstruktive midis elementëve të betonit dhe rivendosjen e kapacitetit të ngarkesës së konstruksionit që riparohet.

CILËSITË

- Rrëshirë e dukshme dy-komponentëshe epoksidike me viskozitet të ulët;
- Adezion i lartë për shtresa të thata ose të lagështa nga betoni;
- Me rezistencë ndaj ujit dhe që nuk lëshon ujë;
- I rezistueshëm ndaj baktereve;
- Rezistencë solide ndaj thartirave të buta, substancave të kripës dhe vajrave minerale;
- I rezistueshëm ndaj naftës dhe derivateve të naftës;

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

| CILËSIA | METODA | VLERA E DEKLARUAR |
|---|---------------|-----------------------------------|
| Pamja (Komponentet A+B) | - | lëng voskoze transparent |
| Përpjestimi i përzjerjes | - | A:B=1,7:1,0 |
| Dendësia | EN ISO 2811-1 | A+B - 1,05-1,09 g/cm ³ |
| Kohë e hapur për punë në temperaturë nga 20 deri 25°C | | deri 60 min. |
| Fortësia e adezionit | EN 1542 | >2MPa |

METODOLOGJIA E REALIZIMIT

PËRGATITJA E BAZËS (NËNSHTRESËS)

Sipërfaqja bazë e betonit duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, e pa yndyrshme dhe pa pluhur, me fortësi ndaj presionit prej të paktën 25 MPa.

Te bazat e sapo punuaratë betonit ADINGPOKS 1PV, rekomandohet që të hidhet të paktën 7 ditë pas kryerjes së betonimit.

Në rast se ADINGPOKS 1PV përdoret si prajmer për baza të tjera epoksidike ose metakrilate, nevojitet që betoni të jetë të paktën 28 ditë i vjetër.

Qumështi i çimentos, vajrat e depërtuara dhe papastërtitë në shtresën bazë duhet të mënjanoen në mënyrë mekanike.

Të gjitha dëmtimet e bazës duhet të sanohen duke përdorur materiale përkatëse të dedikuara për sanim të konstruksioneve të betonit.

Faqja 1 nga 3

HEDHJA E ADINGPOKS 1PV-së SI LYERËS(MBËSHTJELLËS)

Para se të përzihet "brumi", nevojitet që komponentët A dhe B të përzihen veç e veç. Materiali përgatitet me anë të përzierjes të dy komponentëve me përzierës të ngadalshëm elektrik(300 deri 500 rrotullime/min) deri në homogjenizim të plotë. Sasia e materialit që përzihet, duhet të jetë në përputhje me kohën e hapur për përgatitjen e materialit.

Hedhja e materialit kryhet në mënyrë të barabartë përgjatë sipërfaqes, me rul. Te sipërfaqet me porozitet të lartë, mund të hidhet në dy shtresa. Temperatura e bazës gjatë hedhjes duhet të jetë 10°C deri 30°C. Temperatura ambientale gjatë kryerjes së punëve, duhet të jetë nga 10°C do 30°C. ADINGPOKS 1PV mund të hidhet edhe gjatë rritjes relative të lagështisë së ajrit, por rekomandohet që lagështia të mos jetë mbi 80%.

PËRGATITJA E LLAÇIT RIPARUES EPOKSIDIK

Llaçi epoksidik përgatitet me përzierje të ngadalshme të komponentëve A dhe B të Adingpoks 1PV-ishit (deri në barazim të plotë), e pastaj shtohet mbushje kuarci në raportin Adingpoks 1PV : Mbushjes S/H = 1:4 deri më 1:7. Për përzierje përdoret përzierës mekanik i ngadalshëm. Sipërfaqja ku është hedhur llaçi përpunohet në mënyrë finale me mistri çeliku("gletare çeliku"), me dorë ose në mënyrë makinerike(me "gletare" rrotulluese), me ç'rast materiali shtypet deri në mbyllje të tërësishme të të strukturës sipërfaqësore. Sipas nevojës, si llyerës(mbështjellës) final, mund të hidhet Adingpoks 1 ose tjetër llyerës epoksidik për mbylljen e plotë të strukturës. Gjatë përdorimit të llaçit epoksidik për sanim epoksidik është e preferuar të bëhen analiza paraprake.

Për ilustrim është dhënë tabela e mëposhtme ku jepen rezultatet e analizës së llaçit epoksidik të Adingpoks 1PV-së dhe Mbushjes S/H(0,3-0,8 mm) dhe përpjesëtimi i mbushjes Adingpoks 1PV dhe Mbushjes S/H dhe përpjesëtimi i përzierjes Adingpoks 1PV : Mbushjes S/H (0,3-0,8 mm) = 1:4

| CILËSIA | METODA | VLERA E DEKLARUAR |
|--------------------------|----------|--|
| Përpjestimi i përzierjes | - | A+B : Mbushje S/H (0,3-0,8 mm) = 1 : 4 |
| Fortësia në shtypje | EN 12190 | >65MPa |
| Fortësia në adezion | EN 1542 | >2MPa |

-Gjatë përdorimit të llaçit epoksidik për riparim epoksidik, është e nevojshme të kryhen analiza paraprake

INJEKTIMI I PLASARITJEVE

Addingpox 1PV mund të injektohet nën presion duke përdorur pompë injeksioni për materialet një-komponentësh (brenda kohës së hapur të punës së produktit). Injektimi kryhet përmes paketuesve, të cilët janë të pajisur me një "dizne" të pakthyeshme. Paketuesit vendosen në vrima të shpuara direkt në çarje ose në një kënd - ku paketuesi duhet të presë plasaritjen. Pas vendosjes së paketuesve, çarja duhet të mbyllet me stuko epoksidik për të parandaluar rrjedhjen e materialit gjatë injektimit. Distanca në të cilën vendosen paketuesit varet nga gjerësia dhe thellësia e plasaritjes. Në çarjet vertikale, injektimi i Addingpox 1PV-së kryhet vazhdimisht nga paketuesi më i ulët e lart, për të parandaluar "kurthimin" e ajrit në çarje.

SHPENZIMI

Për një shtresë: 0,15 – 0,25 kg/m² (si prajmer si dhe si llyerës)

Për trashësi të shtresës 1cm (si llaç): 19,00 – 21,00 kg/m²

(Adingpoks 1PV : Mbushje C/X (0,3-0,8 mm) = 1:4)

PAKETIMI

Në sete (A+B komponentët): 3 kg

(Komponenti A 1,9 kg dhe Komponenti B 1,1 kg)

Në sete (A+B komponentët): 24,3 kg

(Komponenti A 15,3 kg dhe Komponenti B 9,0 kg)

PASTRIMI


Veprat dhe pajisjet pastrohen me Holluesin P menjëherë pas përdorimit.

RUAJTJA

Në ambalazh origjinal të mbyllur, në hapësira pa lagështi, në temperaturë prej 10°C deri 30°C, të mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë të rrezeve të diellit.

Afati i përdorimit: 9 muaj.

SHENJA E PRODHIMIT TË SERTIFIKUAR

| | |
|--|---|
|  | |
| ADING AD Skopje, Novoselski pat (ul 1409) br.11 1060 Skopje, North Macedonia 20 GDAB001/3 EN 1504-2:2004 EN 13813:2002 SR-B2.0-IR4 | |
| ADINGPOKS 1PV Epoxy primer for wet-damp concrete surfaces | |
| According to EN 1504-2 | |
| Capillary absorption and permeability to water | w < 0,1 kg/m²·h^{0,5} |
| Permeability to water vapour | Class III, S_D ≥ 50 m |
| Adhesion strength by pull-off test | ≥ 2,0 N/mm² |
| According to EN 13813 | |
| Impact resistance | Class I ≥ 4 Nm After loading, no cracks, no delamination |
| Adhesive tensile strength | Class B 2,0 > 2,0 N/mm² |
| Emission of corrosive substances | SR |

Rreziku për jetën: Duhet të evitohet kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe të thithjes përmes frymëmarrjes gjatë përzierjes së komponentëve. Në rast të kontaktit të padëshiruar, prodhimi duhet të mënjanohet menjëherë me leckë të thatë ose të lagur pakëz me Hollues P, e pastaj vendi duhet të lahet me ujë të pastër dhe sapun. Nëse materiali jua spërkat sytë, menjëherë sytë duhet të shpërlahen me ujë të pastër dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Duhet të sigurohet edhe ajrosje të hapësirave ku punohet me rrëshira dhe hollues.

Zjarr: Adingpoks 1PV dhe Holluesi P përmbajnë hollues ndezës. Nuk duhet të përdoren afër zjarrit të hapur ose të pihet duhan gjatë përdorimit të tyre në ndërtim.

Pastrimi dhe ruajtja: Mbetjet e shpërndara të Adingpoks 1PV-së pastrohen me Hollues P. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të ruhet sipas normativës dhe rregullativës lokale për këtë lloj të mbeturinave. Rekomandimi ynë është që mënyra e aplikimit dhe sasive të nevojshme të adaptohen sipas kushteve të objektit, si dhe të përdoren pajisje përkatëse.

Informata plotësuese janë dhënë në Certifikatën e sigurisë së prodhimit.